

RRJETI CSR KOSOVA

Gusht 2018



Rruga "Tringë Smajli", nr. 21
Prishtinë
Republika e Kosovës 10000

E-mail: info@csrkosovo.org
Telefon: +383 38 712 715

Na gjeni në:
Web: csrkosovo.org

Facebook & LinkedIn:
Kosovo CSR Network


Instagram:
[csrkosova](https://www.instagram.com/csrkosova)



CSR KOSOVA DHE UNICEF BASHKË PËR FUQIZIMIN E RINISË SË VENDIT.

Rrjeti CSR Kosova (Kosovo CSR Network) dhe UNICEF kanë nënshkruar me 2 gusht 2018, Memorandumin e Mirëkuptimit, për të bashkëpunuar drejt fuqizimit të rinisë së vendit dhe promovimit të vullnetarizmit në Kosovë. Të dyja palët kanë rënë dakord të eksplorojnë mënyrat e përfshirjes së sektorit privat në realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve në Kosovë, dhe do të punojnë së bashku për të kontribuar në arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara (UN).

Takimi në mes të ekipit të Rrjetit CSR Kosova dhe atij të UNICEF u përcjell me ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit në të cilën palët kanë punuar së fundmi, nga Udhëheqësi i Misionit të UNICEF për Kosovë, Brandao Co, dhe Drejtores Ekzekutive të CSR Kosova, Linda Tahiri Rukiqi. Palët do të punojnë së bashku për të kontribuar në misionin e UNICEF-it për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe rinisë, dhe për të investuar më shumë në aftësitë për jetë dhe punë për rininë Kosovare. Përmes këtij bashkëpunimi, dhe duke ndërmarrë një sërë aktiviteteve që përfshijnë sektorin privat, palët synojnë të kontribuojnë në stabilitetin e vendit dhe prosperitetin në Kosovë.



UNICEF dhe Rrjeti CSR Kosova organizojnë tryezë të rrumbullakët, që fuqia e sektorit privat të përdoret në të mirë të fëmijëve dhe rinisë

Me datë 30 Gusht 2018, Rrjeti CSR Kosova bashkë me UNICEF organizuan tryezën e rrumbullakët me drejtorë dhe pronarë të bizneseve/organizatave të shquara të Kosovës për të identifikuar dhe diskutuar idetë dhe mënyrat e investimit dhe mbështetjes së fëmijëve dhe rinisë nga sektori privat. Kjo ngjarje u organizua pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të UNICEF dhe Rrjetit CSR Kosova në fillim të këtij muaji, ku këto dy organizata janë dakorduar të punojnë së bashku drejt identifikimit të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të caktuara nga Kombet e Bashkuara, për të bashkëpunuar drejt fuqizimit të rinisë së vendit dhe promovimit të vullnetarizmit në Kosovë.



Gjatë tryezës së rrumbullakët udhëheqës të shquar të organizatave treguan pikëpamjet e tyre, përfshirë: Dr. Brandao Co, Shef i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, z. Arian Zeka, Zëvendës Kryetari i Bordit të Rrjetit CSR Kosova. Znj. Linda Tahiri Rukiqi, Drejtore Ekzekutive e Rrjetit CSR Kosova dhe njëherit moderatore e kësaj tryeze, mirëpriti interesimin e të pranishmeve për të kontribuar në aktivitete të përgjegjshme ndaj shoqërisë, dhe tha se shpreson edhe kompani të tjera që veprojnë në Kosovë do të jenë të gatshme të perqafojnë ide inovative dhe të përgjegjshme të cilat kontribuojnë në një zhvillim më të qëndrueshëm.



1

MERIDIAN EXPRESS

Fitues të Çmimit FIDES për kontribut Korporativ

Meridian Express vazhdon të jetë njëra nga kompanitë më të suksesshme në Kosovë, dhe këtij sukcesi i shtohet edhe çmimi për filantropi, ai i "FIDES - në nivel korporativ." Meridian Express njihet si rrjet i dyqaneve i cili me moton "n'derë t'shtëpisë," është njëri nga rrjetet më të suksesshme në Kosovë.

E vecanta e kësaj kompanie është edhe angazhimi dhe përkrahja e ngjarjeve të ndryshme në komunitetin tonë. Si shpërblim i gjithë këtij angazhimi, kompanisë Meridian Express iu nda çmimi për filantropi "FIDES," nga Forumi për Iniciativa Qytetare "FIQ."

Çmimi "FIDES" simbolizon mirënjohje publike për kompanitë dhe individët nga Kosova dhe diaspora të cilët në mënyrë sistematike dhe me ndjeshmëri ndaj ambientit, kulturës dhe vlerave tradicionale kanë mbështetur aktivitete dhe projekte të interesit të përbashkët.



2

Meridian Express jep bursa te studimeve per AUK

Meridian Express mbështet vazhdimisht ata që kanë potencialin më të madh për të transformuar vendin tonë për të mirë. RIT Kosova (A.U.K) është një institucion edukativ shembullor që vazhdimisht krijon rrëfime të reja sukcesi. Prandaj, Meridian Express këtë vit mbështeti këtë insititucion përmes dhënies së bursave për studentë.



3

Për të mirën

Meridian Express përkrahu ceremoninë e ndarjes së 6 çmimeve për ndryshimtarët (njerëzit që kanë bërë ndryshime pozitive në shoqërinë kosovare).Çmimet ishin të dizajnuara ashtu që dhuroheshin për një ndryshim të caktuar në lagje, komunitet, ligj, apo angazhim të ngjashëm."





- Me ndihmën e Raiffeisen Bank hapet qendra e 9-të Informuese për Shëndetin e Gruas edhe në Dragash, me ndihmën e Raiffeisen Bank

Kjo iniciativë ishte e mundur falë bashkëpunimit të organizatës "Akcioni për nëna dhe fëmijë (AMC)" me Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Dragashit, QKMF-së dhe Raiffeisen Bank Kosova.



- Organizim tjetër i dhurimit të gjakut nga anëtarësia e CSR

Me datë 01.08.2018 dhuruan gjak stafi i Raiffeisen Bank Kosova ne Prishtinë, me cilin rast kanë vendosur 2 lokacione të ndryshme për dhurim gjaku në mënyrë që të jenë sa më afër dhuruesve vullnetarë të gjakut!

Bashkëbisedim me sektorin privat rreth mbështetjes së fëmijëve dhe rinisë

